



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 19 tetor 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti, Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Prof.dr. Zejnullah Gruda- ekspert, Lumnije Murati- ZPRK, Shkumbin Beqiri-KDI, Yll Buleshkaj-OSBE.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 12 tetor 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 12 tetor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 12 tetor 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare

Albin Kurti- Njoftoi se grupi i punës i Komisionit për shqyrtimin e Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, e ka përfunduar punën dhe i ka propozuar Komisionit për shqyrtim disa propozim-amendamente.

Hydajet Hyseni - Në cilësi të kryesuesit të grupit të punës, njoftoi Komisionin për angazhimet e grupit të punës rreth amendamentimit të këtij Projektligji dhe për amendamentet e propozuara.

Pas shqyrtimit të amendamenteve të propozuara, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohen amendamentet në Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare nr. 04/L-52, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Ky ligj përcakton procedurën e lidhjes, nënshkrimit, ratifikimit, rezervave dhe deklarave, ndryshimit dhe plotësimit, tërheqjes nga marrëveshja, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës”.

Amendamenti2

Në nenin 2, fshihen fjalët:

“Konventën e Vjenës të 14 Marsit 1975, për Përfaqësimin e Shteteve në Marrëdhëniet e tyre me Organizatat Ndërkombëtare të Karakterit Universal”.

Amendamenti 3

Në nenin 3 hiqen paragrafët 1.5, 1.8, 1.9, 1.10, 1.12 dhe 1.15, si dhe shprehja **“nënkupton”** zëvendësohet me shenjë “:”.

Amendamenti 4

Në neni 3, paragrafi 1.6, në fjalinë e parë, pas fjalës **“marrëveshje ndërkombëtare”** shtohen fjalët **“përkatësisht traktat”** dhe vazhdon teksti i Projektligjit.

Hiqet fjalia e fundit e nenit 3, paragrafi 1.6.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1.13 riformulohet si vijon:

“Ratifikim”- Akt me të cilin Republika e Kosovës në nivelin ndërkombëtar jep pëlqimin e vet të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1.16, fjala **“Tërheqja”** zëvendësohet me fjalët **“Tërheqja nga marrëveshja”**, si dhe të harmonizohet ky zëvendësim në nenin 12 të Projektligjit.

Amendamenti 7

Në nenin 4, paragrafët 2, 3 dhe 4 hiqen, ndërsa paragrafët 1 dhe 5 riformulohen si më poshtë dhe ndryshon radhitja si vijon:

“1. Të drejtën e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare e kanë organet shtetërore të Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin në fuqi.

2. Nismat për marrëveshjet ndërkombëtare që vijnë nga ministritë, miratohen në parim nga Qeveria, pas rekomandimit nga Ministria e Punëve të Jashtme.”

Amendamenti 8

Neni 5 hiqet.

Amendamenti 9

Në nenin 6, paragrafi 1, hiqen fjalët “nëse është i disponueshëm”.

Amendamenti 10

Në nenin 7, paragrafi 1, fjalët “pa autorizime të veçanta” zëvendësohen me fjalët “në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve”.

Amendamenti 11

Nenin 8, paragrafi 4.3, hiqet.

Amendamenti 12

Në nenin 9, pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2 me këtë përmbajtje:

“2. Ministria e Punëve të Jashtme me rastin e dhënies së pëlqimit për fillimin e negociatave, jep pëlqimin edhe për përbërjen e delegacionit, kohën dhe vendin ku do të zhvillohen ato”.

Amendamenti 13

Në nenin 10, paragrafi 1, fjalia “Secila palë shtyp tekstin dy herë në gjuhët zyrtare:” zëvendësohet me fjalinë “Teksti i marrëveshjes dypalëshe ndërkombëtare shtypet në gjuhët e palëve që lidhin marrëveshje, ose edhe në gjuhën tjetër sipas marrëveshjes së tyre:”.

Amendamenti 14

Neni 11, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:”

Amendamenti 15

Në nenin 19, paragrafi 2 dhe 3, pas fjalës “normave” shtohet fjala “universale” dhe hiqen fjalët “të pranuar botërisht” .

Amendamenti 16

Në nenin 19, paragrafi 2, pas fjalëve “nga Kuvendi i Republikës së Kosovës” shtohen fjalët “me dy të tretat e votave”.

4. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me fushëvprimtarinë e Komisionit, sipas Rekomandimit të Nënkomisionit për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

I rekomandohet Nënkomisioni për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit të Kosovës, se fushë veprimtaria e Komisionit për Punë të Jashtme, mbetet ashtu siç është e përcaktuar në Shtojcën nr. 2 pika 5, të Rregullores së Kuvendit në fuqi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

